

Takimi i dhjetë i ekipës për menaxhim të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë

Ekipi menaxhues i projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP)

Përgatitur nga: Departamenti i Sistemeve të Pagesave në BQK

Prishtinë
22 shkurt, 2013

1. Miratimi i procesverbalit dhe konkluzioneve të takimit të fundit (*23 Nëntor 2013*)
2. Qendra Procesuese Ndërbankare - hapat e mëtejme
3. Financimi i ekipit për menaxhim të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme
4. Informacion nga takimet me kompanitë e shërbimeve publike
5. Propozimet e nëngrupit të Shtyllës së III-të
6. Asistenca e Visa dhe MasterCard për reduktim të parasë së gatshme në Kosovë

1. Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit

- Inkurajimi i përdorimit të pagesave elektronike për kryerje të transaksioneve përveç tjerave forma të diskutuara edhe paraprakisht të inkurajohet edhe përmes zbritjes së tarifave për pagesa jo në cash
 - BQK-ja ka zbritë tarifat e shërbimeve për pagesa elektronike në SEKN (50-80%), në fuqi që nga 1 shkurti, 2013
- Të analizohet mundësia e zbritjes së tarifave për pagesat Kos-Giro (për të gjitha llojet, cash dhe jocash, vlen marrëveshja ende në fuqi në bazë të numrit të rritur), por më në veçanti apo menjëherë të analizohet zbritja për pagesat giro të cilat kryhen përmes llogarive bankare, me e-banking, përmes ATM-ve, etj, dhe përmes SHBK-ës të jepet një përgjigje brenda dy javëve;
 - Disa banka (3) kanë dërguar komentet
- Për mundësinë e implementimit të qendrës procesuese ndërbankare siç është propozuar nga MasterCard, (bankat të dërgojnë komentet e tyre me shkrim brenda dy javëve, direkt apo edhe përmes SHBK-ës Disa banka (3) kanë dërguar komentet
- Bankat të dërgojnë përgjigjet e tyre lidhur me propozimin që secila bankë (përfshirë edhe BQK-në) të kontribuojë me nga 2000 Euro në zhvillimin e kampanjave edukative për përdorim të pagesave përmes llogarive, shërbimet elektronike (brenda dy javëve). Disa banka (3) kanë dërguar komentet, tjerat në forma të ndryshme (verbalisht, etj)

2.Qendra Procesuese Ndërbankare - hapat e mëtejme

- Shtylla e III e SZHSPK (http://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemilPagesave/Vizioni_i_se_ardhmes_se_sistemit_kombetar_te_pagesave.pdf)
- Sipas raporteve të Bankës Botërorë për DSP “Kosovo Financial sector strengthening market infrastructure project” tetor, 2012 dhe asistenca e kërkuar për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave, dërgesa nga jashtë “remitenca” dhe pikë kryesore për “**Interbank Card Switch**”

Hapi 1. Analiza Financiare (ekipa punuese e kordinuar nga DSP/BQK)

Hapi 2. Shqyrtimi i Analizës, vlerësime dhe propozimi konkret ideor (plani) (BQK, Bankat Komerçiale, Institucione tjera relevante brenda dhe jashtë, si BB, FMN, etj)

Hapi III. Zhvillimi I Projektit

Hapi IV. Prokurimi dhe implementimit

3. Financimi i ekipit për menaxhim të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme

- Secili pjesëmarrës në Sistem të Pagesave të kontribuoj së paku me nga 2 000 Euro, duke përfshirë edhe BQK-në, për të përkrahur zhvillimin e kampanjave vetëdijësuese për përdorimin e pagesave elektronike.
- Përkrahja financiare nga ana e VISA's : *“Visa ka premtuar një buxhet prej US\$ 10,000 që të jetë në dispozicion vitin e ardhshëm... mjetet të investohen në zhvillimin e një web-i lokal dhe VISA mund të përkrah me përmbajtjen e tij “.*

4. Informacion nga takimet me kompanitë e shërbimeve publike

Skema Kos-GIRO dhe Debitim Direkt

- **Kos-GIRO** - është shtuar versioni **V. 1.5** i faturës bardh e zi, me të cilën lehtësohet pjesëmarrja e kompanive të vogla në këtë skemë. (<http://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemilPagesave/Mostra%20e%20KOS%20GIRO.zip>)
- **Debitim Direkt** - Përshtatjet në anën rregullative dhe teknike në skemë që të mundësohet nënshkrimi i marrëveshjes (autorizimit) në bankën e debitorit.
 - Këto përshtatje janë pranuar nga të gjithë pjesëmarrësit përveç **KEK-ut**, dhe për këtë kompani (më të madhe në pjesëmarrje në DD) janë ofruar tri opsione shtesë të mundshme dhe në pajtim me rregullativë për tu realizuar. Kërkohet bashkëpunim kompani bankë komerciale për realizim të cilësdo variant që dakordohen banka dhe kompania:
 1. Shkëmbimi i kopjeve fizike të autorizimit Bankë e Klientit-Kompani, Kompani - Bankë e Klientit
 2. Shfrytëzimi i ueb serviseve të publikuara nga kompanitë
 3. Krijimi i mesazheve shtesë në skemën e DD-së me qëllim të shkëmbimit të informacioneve të autorizimit

5. Propozimet e nëngrupit të Shtyllës së III për Qendren Procesuese(1)

Konkluzionet e grupit për Qendrën Procesuese - analiza dhe vlerësimet:

- Tarifat për transferet ndërbankare me kartela nga Visa & MasterCard përmes shërbimeve “Domestic Net Settlement Service” nuk janë të larta.
- Bankat komerciale operojnë me qendrat e tyre (të ndryshme) të procesimit dhe nuk shihet e arsyeshme anashkalimi i tyre për të funksionuar me një Qendër Nacionale të përbashkët.
- Nuk shihet në interes:
 - shfrytëzimi i një karteje nacionale pa brand të VISA ose MasterCard, të cilat do mund të operonin vetëm në nivel nacional.
 - Largimi i infrastrukturës ekzistuese të terminaleve (ATM dhe POS) dhe krijim i një infrastrukture të përbashkëta për të operuar me kartela.
 - Largimi nga sistemet e pagesave ndërkombëtare si VISA dhe MasterCard .
- Implementimi i një Qendre Nacionale të Procesimit të transaksioneve me kartela do kishte shpenzime dhe ngarkesë shtesë nga ato ekzistuese

5. Propozimet e nëngrupit të Shtyllës së III për Qendren Procesuese (2)

Konkluzionet e grupit për Qendrën Procesuese - propozimet dhe hapat e metejshëm

- Në këtë fazë shihet e arsyeshme krijimi i një sistemi që do të mundesonte shlyerjen e transaksioneve ndërbankare me kartela në BQK (Settlement Agent):

- Mjetet për shlyerje do të mbahen në BQK, e jo në bankat e jashtme (VISA- Bank of America, MasterCard – Deutsche Bank).
- Nuk ka nevojë të ketë ndryshime në skemën ekzistuese të funksionimit si për autorizime dhe kliring të transaksioneve.
- Visa dhe Master ofrojnë një mundësi të tillë dhe skemat e ngjashme janë të implementuar në shtetet e rajonit (Shqiperi, Maqedoni)
- Nëse është e pranueshme, grupa mund të filloj përgatitjen e detaleve teknike për mënyrën e implementimit të këtij sistemi.

Rekomandimet për tarifat me qëllim të ngritjes së përdorimit të terminaleve (ATM, POS):

- Nga bankat të analizohet mundësia e zbritjes së tarifave për klientët e tyre (persona fizik dhe “merchant”) për transferet ndërbankare me ATM dhe POS.
- Të diskutohet me Qendrat Procesuese Ndërkombëtare çmimorja për licencat për operim, produktet, ngarkesat për mirëmbajtje të produkteve, etje
- Të shikohet mundësia e anëtarësimit të sa me pak bankave si “Principal Member” në Qendrat Procesuese Ndërkombëtare në.
- Të negociohet në mes bankave çmimorja për “Interchange Fee” e aplikueshme nga VISA&MC për Kosovë, dhe të konfirmohet nga VISA & MC.

6.Asistenca e Visa dhe MasterCard për reduktim të parasë së gatshme në Kosovë

Oferta dhe mundësitë e VISA dhe MasterCard janë diskutuar në takimet e mëhershme.
Nëngrupi i Shtyllës së III-të

Opinionet e pjesëmarrësve për mundësitë dhe fushat e asistencës (si, çka, ??)

Faleminderit

<http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,55>